



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:263816

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05835765

KF.nr.580/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit N.T.Sh. “Edoni Com” me numër unik identifikues 810431114 dhe seli në zonën industriale Fushë Kosovë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlera e kontestit e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në mungesë të palës paditëse, e në prani të përfaqësueses të autorizuar të palës së paditur A.H.D., me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.Sh. “Edoni Com” me seli në zonën industriale, Fushë Kosovë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI aktvendimi nr.07.3/134/2014, i datës 19.04.2016 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.Sh. “Edoni Com”, me seli në zonën industriale Fushë Kosovë, me padinë e paraqitur në Gjykatë ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ me datë 16.05.2016, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktvendimit nr.07.3/134/2014 i datës 19.04.2016, për shkak të vërtetimi të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizës, rivlerësimit të gabuar të mallit nga Dogana e Kosovës dhe rritjes së bazës doganore për mallin e importuar sipas DUD-it. Tutje në padi ka theksuar se Dogana e Kosovës nuk e ka marr parasysh faktin se subjekti N.T.Sh. “Edoni Com”, ka ekskluzivitetin e shpërndarjes

të veglave të punës të prodhuara nga kompania “Eltos Hand Tools” L.T.D, në Kosovës, këtë fakt Dogana gjatë rivlerësimit të mallit nuk e ka marr në konsideratë edhe pse ky fakt ka shumë rëndësi në përcaktimin e vlerës së mallit. Më tej ka shtuar se Dogana e Kosovës duke e rritur bazën doganore të mallit të importuar nga subjekti në procedurë padrejtësisht po e dëmton subjektin dhe po i shkakton dëme të konsiderueshëm monetare. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia, të anulohet vendimi i Doganës së Kosovës nr.07.3/134/2024 të datës 19.04.2016 si i pa bazë dhe të obligohet Dogana që të pranoj vlerën e mallit sipas nenit 33 të Kodit Doganor, respektivisht sipas vlerës së transaksionit dhe ankuesit ti kthehen mjetet monetare të cilat janë paguar më tepër si rrjedhojë e rivlerësimit të mallit. Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar-administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës paditëse ngase Gjykata pas disa tentimeve për dorëzimin e ftesës paditësit, nuk rezultoi të jetë dorëzimi i suksesshëm meqenëse i njëjti nuk gjendej në adresë nga Posta e Kosovës. Gjykata me datë 20.05.2024 ftesën për seancë e ka shpallur në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate, po ashtu me datë 21.05.2024 nga Posta ka pranuar zarfin ku shihet se në tentimin e tretë me datë 16.05.2024 paditësi e ka refuzuar pranimin e të njëjtës.

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetim se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesja e autorizuar e palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.06.2024 ka deklaruar se mbasin në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, po ashtu ka shtuar se mbasin në tërësi pranë deklarimeve nga seanca paraprake pasi aktvendimi i atakuar në padi është marr konform dispozitave ligjore të KDA-së neni 35. Sa i përket obligimit nga gjykata që pala e paditur ta njoftoj gjykatën lidhur me vlerën e kontestit e paditura deklaron se vlera e kontestit është 1,407.66 euro. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e administruara në këtë seancë u vërtetua se vendimi i atakuar me padi është marrë konform dispozitave ligjore që e rregullojnë mënyrën e vlerësimit të mallrave, mandej paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ka arritur të prezantoj dokumentacion të harmonizuar për të dëshmuar vlerën e transaksionit, andaj padia dhe kërkesëpadia është e pabazuar. Gjykatës që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin e atakuar me padi si të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.118/22, të datës 03.07.2023, e ka aprovuar ankesën e të paditurës, Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë e datës 24.03.2020 dhe e ka prish aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.734/16, të datës 04.02.2020, dhe lëndën e kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës Parë- Departamenti për Çështje Fiskale, në rigjykim dhe rivendosje, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë ka vërtetur në mënyrë të gabuar gjendjen faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk e ka përcaktuar saktë vlerën e detyrimeve të paditësit të paguar më tepër në emër të taksave doganore, ku gjykata e shkallës së parë në ri procedurë gjyqësore, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues, po ashtu gjykata duhet të veproj konform nenit 356 të LPK-së dhe dispozitave për plotësim dhe ndryshim të këtij ligji 04/L-118 respektivisht nenit 21, të caktoj ekspertizën financiare duke e siguruar obligimin e saktë të paditurës dhe atë në vlerë monetare.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 13.06.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi 07.3/134/2014 i datës 19.04.2016, Aktgjykimi A.nr.589/2014, Vendimi nr. 07.3.134 i datës 06.03.2016, DUD 2340 datës 05.02.2014, Fatura nr. 842325 datës 31.01.2014, Dokumenti i datës 31.01.2014 nr.842325, Deklarata eksportuese e datës 31.01.2014, Kontrata e datës 23.12.2013, Pagesa bankare e datës 22.04.2014, Kontrata e datës 23.12.2013, Pagesa bankare e datës 22.04.2014, Dokumenti me nr. 1400099, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave për DUD kontestues, Certifikata e origjinës nr. 0199993, Numrat e dosjes së vlerës, Dokumenti Asycuda.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi, përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, aktvendimit kontestues, dhe deklarimeve në seancën eshqyrtimit kryesor, gjykata ka gjetur se subjekti N.T.SH “Edoni Com”, ka paraqitur për zhdoganim mallin doganor “vegla të ndryshme të punës” sipas dokumenteve përcjellëse të mallit. E paditura e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit nga paditësi, e ku si rezultat i kësaj përmes

procesit mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, ka caktuar bazë të re doganore për këtë mall, duke u bazuar në metodën e gjashtë (6) të vlerësimit nga neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Nr.03/L-109, respektivisht në bazë dhënave të disponueshme të Kosovës për disa emërtime të DUD-ave kontestuese. Padiësi ka ushtruar ankesë në Sektorin Rishqyrtimit i cili ka lëshuar aktvendimin 07.3/134 të datës 06.03.2014 në të cilën është refuzuar ankesa si e pa bazuar. Padiësi ka parashtruar ankesën në Gjykatën Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, e cila Gjykatë ka nxjerr aktgjykimin A.nr.589/2014 në të cilën e ka aprovuar si të bazuar ankesën/padinë si të bazuar dhe e ka anuluar aktvendimin e Doganës së Kosovës, dhe lëndë e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjithashtu jo kontestues mbetet fakti se Dogana e Kosovës duke vepruar sipas aktgjykimit A.nr.589/2014 të datës 11.11.2015 e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë si të pa bazuar, e kundër këtij aktit administrativ përfundimtar padiësi ka parashtruar padi me datë 16.05.2016 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizioni Fiskal.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44, par. 1, të LKA-së, duke u kujdesur edhe sipas detyrës zyrtare për nulitetin e aktit administrativ, kjo sipas par. 2, të këtij neni. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e padiësit të shprehura në padi, meqenëse padiësi ka refuzuar pranimin e ftesës për seancë në tentimin e tretë me datë 16.05.2024 kjo vërtetohet me zarfin e postës se i njëjti ka refuzuar pranimin e ftesës, andaj gjykata e ka pasur të pa mundur të përcaktoj saktë vlerën e detyrimeve të padiësit të paguar më tepër në emër të taksës doganore, e që sipas nenit 7, Parag 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L- 006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga këto dispozita Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38 par. 2 të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala padiëse duhet të parashtrtoj faktet në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve. Edhe përkundër njoftimit të të paditurës lidhur me vlerën e kontestit, në pamundësi të dëgjimit të palës dhe precizimit të kërkesëpadisë, Gjykata nuk ka mundur të vendos ndryshe nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi meqenëse e njëjta vepron vetëm në bazë të kërkesave të palëve.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 43, parag. 1, dhe nenit 46, parag. 2, të LKA-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.580/23 datë 13.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.